



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

PROGRAMI
LEXIM-SHKRIM

Tiranë, 2017



Programi i lexim- shkrimit është hartuar nga IZHA dhe do të shërbejë për ndërtimin dhe zhvillimin e njohurive dhe aftësive bazë, të nxënësve në arsimin 9-vjeçar, të cilët kanë pasur arritje të dobëta në lexim- shkrim.

Grupi i punës përbëhet nga:

- Erida Koleci, specialiste e kurrikulës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë, IZHA.
- Rezana Vrapit, drejtore e Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
- Gjergj Vangjeli, drejtor i shkollës “Ardian Klosi”
- Elda Lako, zv/drejtore e shkollës “Edith Durham”

Përmbajtja

I.	HYRJE	4
II.	QËLLIMET E PROGRAMIT TË LEXIM- SHKRIMIT	4
III.	KORNIZA KONCEPPTUALE E PROGRAMIT	4
II.	KOHA MËSIMORE	5
2.1	Koha mësimore për nxënësit që do të ndjekin të dyja modulet	6
2.2	Koha mësimore për nxënësit që do të ndjekin vetëm modulën e dytë	6
III.	MODULI 1: LEXIM- SHKRIMI FILLESTAR	6
3.1	Të lexuarit fillestar	7
3.2	Të shkruarit fillestar	8
IV.	MODULI 2: LEXIM- SHKRIMI I KUPTIMSHËM	10
4.1	Të lexuarit e kuptimshëm	11
4.2	Të shkruarit e kuptimshëm	13
V.	ZBËRTHIMI I PROGRAMIT TË LEXIM- SHKRIMIT	14
VI.	UDHËZIME METODOLOGJIKE	16
6.1	Kriteret e procesit mësimor	17
VII.	VLERËSIMI I NXËNËSIT	17
VIII.	MATERIALE DHE BURIME MËSIMORE	19

I. HYRJE

Të lexuarit dhe të shkruarit janë kompetencat më të rëndësishme që duhet të zhvillojë çdo fëmijë gjatë shkollimit. Ato, jo vetëm janë thelbësore për nxënien e të gjitha lëndëve në shkollë, por janë edhe kompetenca themelore për jetën. Fëmijët të cilët nuk kanë aftësi të mira leximi dhe shkrimi, në të ardhmen kanë mundësi të kufizuara ekonomike dhe zhvillimore.

Të lexuarit ka rëndësi jo vetëm për individin, por edhe për ekonominë dhe shoqërinë në tërësi. Studimet tregojnë se niveli mesatar i leximit të popullsisë së një vendi është një parashikues i mirë i rritjes së tij ekonomike.

Njohuritë dhe aftësitë bazë për të lexuarit dhe për të shkruarit, nxënësi i fiton gjatë arsimit fillor. Nëse në këtë cikël, nxënësi nuk fiton rrjedhshmërinë e duhur në lexim dhe shkrim, atëherë e ka shumë të vështirë që të përmbushë kërkesat e shkollës. Prandaj mësuesit e arsimit fillor, pikësëpari janë mësues të lexim- shkrimit dhe ky është roli i tyre më i rëndësishëm. Por vlerësimet e fundit e realizuara nga QSHA (Qendra e Shërbimeve Arsimore) tregojnë se në arsimin 9-vjeçar ka nxënës, të cilët kanë arritje të dobëta në lexim- shkrim, sidomos në aftësitë e lexim- shkrimit të kuptimshëm.

Ky program ofron mundësinë që këta nxënës të përvetësojnë njohuritë dhe aftësitë bazë në lexim- shkrim. Programi, gjithashtu, do t'u vijë në ndihmë mësuesve për të ndërtuar procesin e mësimdhënies. Natyrisht që puna me këto nxënës duhet të vijojë edhe në të ardhmen, por ky program është një mundësi e mirë për të filluar.

II. QËLLIMET E PROGRAMIT TË LEXIM- SHKRIMIT

Qëllimet e programit të lexim- shkrimit janë:

- Ofrimi i mundësive për nxënësit që kanë arritje të ulëta në lexim- shkrim që të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë bazë në lexim- shkrim;
- Aftësimi i nxënësve në lexim- shkrimin fillestar.
- Aftësimi i nxënësve që të kuptojnë, interpretojnë dhe analizojnë përmbajtjen e një teksti të thjeshtë.
- Zhvillimi i aftësive bazë për të shkruarit e teksteve të ndryshme.
- Krijimi i mundësive që nxënësit të shmangin pengesat në procesin e të nxënies dhe të marrin pjesë aktive në të.

III. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT

Programi i lexim- shkrimit është konceptuar në dy module:

- Lexim- shkrimi fillestar.
- Lexim- shkrimi i kuptimshëm.

Për çdo modul është sugjeruar koha mësimore. Gjithashtu, për çdo modul janë përshkruar edhe drejtimet kryesore, në të cilat do të përqendrohet puna e mësuesit. Në program janë pasqyruar edhe njohuritë dhe aftësitë e të lexuarit dhe të shkruarit fillestar, si dhe njohuritë dhe aftësitë e të lexuarit dhe të shkruarit të kuptimshëm.

Për të lehtësuar procesin e zbatimit të programit janë përshkruar kërkesat për zbatimin e programit, udhëzimet metodologjike, udhëzimet për vlerësimin dhe sugjerimet për materialet mësimore që mund të përdoren.

Përdoruesit e këtij programi janë: mësuesit dhe drejtoritë e shkollave, nxënësit, specialistët e arsimit, prindërit dhe komuniteti.

Mësuesit do ta përdorin programin e lexim- shkrimit për të pasur një tablo të qartë rreth njohurive dhe aftësive të domosdoshme që duhet të zotërojnë nxënësit dhe se si duhet të ndërtojnë mësimdhënien për të përmbushur kërkesat e programit.

Drejtimesit e shkollave do ta përdorin këtë program për të mbështetur mësuesit dhe nxënësit në ndërtimin e njohurive dhe të aftësive të domosdoshme të lexim- shkrimit, si dhe për të monitoruar dhe për të vlerësuar mësuesit dhe nxënësit gjatë gjithë procesit të zbatimit të këtij programi.

Prindërit dhe komuniteti mund të informohen nëpërmjet programit për njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat që duhet të zotërojnë fëmijët e tyre në lexim- shkrim.

Specialistët e arsimit do ta përdorin programin e lexim- shkrimit për qëllime inspektimi, monitorimi, vlerësimi, studimi etj.

II. KOHA MËSIMORE

Siç është thënë më lart, programi i lexim- shkrimit është konceptuar në dy module. Moduli i parë është “Lexim- shkrimi fillestar”, ndërsa moduli i dytë është “Lexim- shkrimi i kuptimshëm”.

Nxënësit që nuk njohin shkronjat do të ndjekin të dyja modulet. Në program është sugjeruar koha për secilin modul, por mësuesit janë të lirë dhe fleksibël në përdorimin e kësaj kohe, në varësi të arritjeve dhe të ecurisë së nxënësve. Ky modul zhvillohet në 100 orë mësimore (5 orë x 20 javë mësimore). Gjatë çdo ore mësimi do të punohet me nxënësit për aftësitë e të lexuarit dhe aftësitë e të shkruarit.

Nxënësit që i njohin shkronjat, por që nuk lexojnë rrjedhshëm, nuk arrijnë të kuptojnë atë që lexojnë (lexim i kuptimshëm) do të ndjekin modulën e dytë. Në këtë rast moduli i dytë do të zhvillohet në 60 orë mësimore (5 orë x 12 javë mësimore).

Ora e mësimimit në të dyja modulet do të jetë 60 minuta.

2.1 Koha mësimore për nxënësit që do të ndjekin të dyja modulet

Moduli	Orë mësimi në javë (60 minuta)	Javë mësimore	Orë mësimi gjithsej
Lexim- shkrimi fillestar	5 orë	12 javë	60 orë
Lexim- shkrimi i kuptimshëm	5 orë	8 javë	40 orë

2.2 Koha mësimore për nxënësit që do të ndjekin vetëm modulën e dytë

Moduli	Orë mësimi në javë (60 minuta)	Javë mësimore	Orë mësimi gjithsej
Lexim- shkrimi i kuptimshëm	5 orë	12 javë	60 orë

III. MODULI 1: LEXIM- SHKRIMI FILLESTAR

Ky modul përbën bazën për programin e shkrim- leximit, pasi gjatë gjithë modulit mësohen të gjitha shkronjat e tingujt e alfabetit dhe jepen bazat e lexim- shkrimit, të cilat do të jenë mbështetje për modulën e mëtejshëm.

Për zhvillimin e këtij moduli janë sugjeruar 60 orë mësimi (ora e mësimimit është 60 minuta). Moduli përshin: njohjen me alfabetin; njohjen e tingujve dhe të shkronjave; leximin e shkrimit të tyre; njohjen e rrokjeve dhe bashkimin e tyre për formimin e fjalëve; njohjen e fjalëve të shkurtra dhe lexim- shkrimit të tyre, për të arritur rrjedhshmërinë në të lexuar; pasurimin e fjalorit.

Për çdo grup shkronjash janë planifikuar orë për lexim e shkrim dhe orë për të përsëritur shkronjat e mësuara ((shih zërrthimin e modulit). Për mësimin e lexim- shkrimit fillestar është e këshillueshme të përdoret metoda analitike - sintetike, me qëllim që të lexuarit të jetë i

vetëdijshëm dhe i logjikshëm dhe që nxënësit të kuptojnë atë që lexojnë, kjo për faktin se gjuha shqipe është gjuhë fonetike, pra tingulli shkruhet ashtu si shqiptohet.

Puna e mësuesit, gjatë kësaj faze duhet të përqendrohet te rrjedhshmëria në lexim. Rrjedhshmëria është një urë midis deshifrimit dhe kuptimit të tekstit. Lexuesit e rrjedhshëm janë më të aftë të kuptojnë se çfarë lexojnë, pasi ata mund t'i identifikojnë lehtësisht fjalët. Nxënësit që nuk janë lexues të rrjedhshëm, shpesh lexojnë në mëdyshje, fjalë-fjalë dhe me sforcim të dukshëm. Këta nxënës shpenzojnë shumë energji mendore për të identifikuar fjalët, duke lënë kështu pak energji për të kapur kuptimin. E kundërta do të ndodhte nëse do të identifikonin lehtësisht fjalët. Atëherë do të kishte më shumë energji të kuptimi. Pra, rrjedhshmëria në lexim është kusht për të kuptuar ose jo një tekst. Disa nga strategjitë që mund të përdorë mësuesi për të aftësuar nxënësit të lexojnë rrjedhshëm janë:

- Mësimi i rrjedhshmërisë.
- Sigurimi i mbështetjes (leximi në çift).
- Nxitja e përsëritjes së të lexuarit.
- Kthimi në rutinë.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe do të jepen konceptet e kategorive gramatikore: fjala, fjalia, emri, mbiemri dhe folja, por jo si qëllim më vete.

3.1 Të lexuarit fillestar

Rezultatet e të nxënësit	
Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - përdor njohuritë për tingujt, shkronjat dhe fjalët; - lexon dhe kupton tekste të thjeshta letrare dhe jo letrare, duke përdorur një sërë strategjish për të ndërtuar kuptimin; - identifikon pikat e forta si lexues, elementet që duhet të përmirësojë. 	
Njohuritë	Aftësitë
<ul style="list-style-type: none"> - Shkronjat e alfabetit dhe tingujt. - Zanoret. - Bashkëtingëlloret. - Rrokja. - Fjala. - Tiparet dalluese të fjalisë (<i>fillimi me shkronjë të madhe dhe shenja e pikësimit në fund</i>). - Studim tekstesh letrare: përralla të shkurtra, fabula, tregime me figura, gjëegjëza, poezi të thjeshta. 	Të lexuarit fillestar Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - njeh tingujt dhe shkronjat e gjuhës shqipe; - dallon rrokjen, fjalën dhe fjalinë; - përdor lidhjen mes shkronjës dhe tingullit për të lexuar dhe për të kuptuar fjalë të reja; - bashkon shkronjat dhe rrokjet për të lexuar fjalët; - ndan fjalët në rrokje; - dallon tiparet kryesore të fjalisë;

<ul style="list-style-type: none"> - Studim tekstesh jo letrare: kartolina, letra të thjeshta, rregulla të thjeshta praktike, orari i mësimëve, kalendar etj. 	<ul style="list-style-type: none"> - lexon rrjedhshëm tekste të thjeshta, afërsisht 50-70 fjalë në minutë; - lexon me zë një tekst (afërsisht gjysmë faqeje) të palexuar më parë; - përdor ilustrimet për të kuptuar më mirë një tekst; - formon fjali me fjalët e reja në një tekst; - u përgjigjet pyetjeve të mësuesit në lidhje me përmbajtjen e tekstit; - lidh tekstin me përvojat e tij personale ose të tjerëve; - shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë letrar, përmes të folurit, shkrimit etj.; - identifikon personazhet kryesore dhe, në bashkëveprim me moshatarët, luan rolin e njërit prej personazheve; - shpreh përjetimet që e kanë shoqëruar leximit të një teksti të thjeshtë në njërin nga format shprehëse: me gojë, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.
<p>Vlerat dhe qëndrimet</p>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - tregon interes dhe dëshirë për të lexuar; - shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit; - ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit. 	

3.2 Të shkruarit fillestar

<p>Rezultatet e të nxënit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan për të komunikuar idetë e veta tek të tjerët nëpërmjet fjalëve, fjalive etj.; - shkruan tekste të thjeshta (urim, letër, kartolinë) sipas modeleve të dhëna. 	
<p>Njohuritë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkrimi i shkronjave të gjuhës shqipe. - Shkrimi i fjalëve tre- deri katërrokëshe. - Shkrimi i fjalisë dhe vendosja e shenjës së pikësimit në fund të saj. - Shkrimi i fjalisë, nisur nga një ilustrim. - Shkrimi i diktimeve (me ndihmën e mësuesit). 	<p>Aftësitë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan drejt shkronjat e gjuhës shqipe; - shkruan fjalë të thjeshta deri me tri rrokje; - vendos në formën e duhur fjalët në vendet që mungojnë;

<ul style="list-style-type: none"> - Shkrimi i një kartoline ose i një urimi sipas modeleve të dhëna. - Shkrimi i tregimeve të thjeshta, nisur nga disa ilustrime. 	<ul style="list-style-type: none"> - shkruan dhe lidh kuptimshëm fjalët në struktura fjalish; - shkruan fjali të thjeshta sipas strukturës: kryefjalë, kallëzues, pjesë plotësuese; - shkruan fjali me të diktuar; - shkruan fjali me të kopjuar; - kopjon pjesë që kanë dialog, deri në 3-4 fjali; - shkruan duke plotësuar pjesë që mungojnë, të fjalës ose të fjalisë; - u përgjigjet me shkrim pyetjeve të ndryshme; - shkruan tregime të thjeshta nisur nga figurat që i ofrohen; - shkruan një kartolinë ose një urim, sipas modeleve të dhëna; - emërton sende dhe frymorë, i veçon mbi bazën e figurave apo të dëgjimit të emërtimeve të tyre; - shkruan me shkronjë të madhe në fillim të fjalive; - shkruan me shkronjë të madhe emrat e njerëzve; - shkruan në mënyrë intuitive drejt fjalët sipas modelit (<i>një –shumë</i>); - shkruan duke imituar modelin dhe me intuitë fjalët që tregojnë veprime që kryhen në të shkuarën, në të tashmen dhe në të ardhmen; - shkruan fjalë që tregojnë cilësi; - ushtrohet për të shkruar drejt dhe pa gabime; - përdor shenjat e pikësimit, si: pikën (.) e pikëpyetjen (?); - përdor shkronjën e madhe në titujt e pjesëve dhe tek emrat e njerëzve; - respekton shkronjën e madhe në fillim fjalisë.
<p>Vlerat dhe qëndrimet</p>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; - respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; - vlerëson punët e të tjerëve; 	

- bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.

IV. MODULI 2: LEXIM- SHKRIMI I KUPTIMSHËM

Ky modul zhvillohet pasi nxënësit kanë mësuar shkronjat dhe mund të lexojnë e të shkruajnë. Gjatë mësimave të këtij moduli nxënësit do të lexojnë dhe do të shkruajnë tekste të shkurtra letrare dhe jo letrare (afërsisht gjysmë faqe). Për të mundur leximin dhe kuptimin e teksteve, mësuesi duhet të ketë parasysh elementet e mëposhtme:

- Strategjitë e të lexuarit.
- Aktivizimi i njohurive e mëparshme të nxënësit.
- Zhvillimi një bisedë hyrëse rreth tekstit për të nxitur kureshtjen dhe interesin e nxënësit.
- Përdorimi i llojeve të ndryshme të të lexuarit: leximi në kor (*nëse nxënësit janë të rritur nuk sugjerohet të përdoret shumë ky lloj leximi*), leximi i drejtuar, leximi në çift, leximi në heshtje.
- Rileximi disa herë i tekstit për të fituar rrjedhshmëri.
- Demonstrimi i kuptimit të tekstit (*nxënësi u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes; parashikon dhe argumenton se çfarë do të ndodhë më pas, kur e lexon tekstin pjesë- pjesë; tregon përmbajtjen ose brendinë; rendit ngjarjet si në tekst; shkruan shkurtimisht brendinë; formulon një hyrje ose një mbyllje të re për tekstin; luan me role etj.*).
- Zgjerimi i të kuptimit të tekstit (*nxënësi lidh tekstin me njohuritë e mëparshme ose me tekste të tjera*).
- Analiza e teksteve (*nxënësi identifikon idenë kryesore; ndan tekstin në pjesë; fillimisht me ndihmën e mësuesit, analizon personazhet, mjedisin, kohën etj.*).
- Gjykimi dhe vlerësimi i teksteve (*nxënësi shpreh me gjuhë të thjeshtë gjykimet dhe pëlqimet e tij rreth teksteve*).

Ndërsa për të shkruarit mësuesi duhet të ketë parasysh elementet e mëposhtme:

- Të shkruarit si proces (*puna përgatitore, organizimi, rishikimi dhe redaktimi i të shkruarit*).
- Të shkruarit e teksteve për qëllime të ndryshme.

Duhet theksuar që njohuritë gramatikore që jepen në këtë modul nuk do të kërkohen me rregulla e përkufizime, por thjesht të njihen nga nxënësit për një komunikim me të mirë me gojë e shkrim.

4.1 Të lexuarit e kuptimshëm

Rezultatet e të nxënit	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon rrjedhshëm një tekst letrar ose jo letrar të palexuar më parë; - tregon brendinë, analizon, gjykon dhe vlerëson me fjalë të thjeshta tekstin; - jep përshtypjet e veta në lidhje me një tekst të shkurtër letrar (poezi, përralla nga folklori, përralla nga autorë të ndryshëm, tregime, fabula) dhe jo letrar (udhëzim, letër, ditar). 	
Njohuritë	Aftësitë
<p>Studim tekstesh letrare: përralla, fabula, tregime, gjëgjëza, poezi.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njohuri të thjeshta e të përgjithshme për tiparet: <ul style="list-style-type: none">)] e përrallave;)] e fabulave;)] e tregimeve;)] e gjëgjëzave;)] e poezive (p.sh., <i>shkruhen në vargje, strofa</i>). - Njohuri për elementet e teksteve, si: paragrafi, titulli, rreshti, strofa, vargu. <p>Studim tekstesh jo letrare: kalendarë të thjeshtë, rregulla praktike, udhëzime, kartolina, letra, fjalorë të thjeshtë, revista për fëmijë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njohuri të thjeshta për elementet e një kalendari, letre drejtuar një të afërmi, një kartoline etj. 	<p>Të lexuarit fillestar</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon rrjedhshëm tekste të ndryshme; - lexon afërsisht 70-90 fjalë në minutë; <p>Të lexuarit për të kuptuar</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor strategjitë e të lexuarit ¹për të kuptuar tekstet që lexon; - parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyç të tekstit; - pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti ose rreth fjalëve të panjohura për të (<i>Ku? Kur? Pse? Si ndodh kjo? Çfarë do të thotë?</i>); - rilexon tekstin për të fituar rrjedhshmërinë e duhur dhe për ta kuptuar më mirë atë; - nënvizon, gjatë leximit, pjesët më të rëndësishme ose pjesët që i pëlqejnë më shumë (<i>edhe me ndihmën e mësuesit</i>); - u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes ose brendisë së tekstit; - tregon me fjalë të thjeshta brendinë ose përmbajtjen e tekstit, duke dhënë shembuj nga teksti; - rendit ngjarjet sipas radhës që rrëfohen në tekst; - lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, me udhëtime, me përvoja personale, me

¹ Strategjitë e të lexuarit janë: parashikimi, vizualizimi, parashtrimi i pyetjeve, nxjerrja e informacionit, përcaktimi i rëndësisë, përmbledhja.

	<p>ngjarje nga jeta e tij etj., ose me tekste të lexuara më parë;</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit (<i>Si ndiheni pasi keni lexuar këtë përrallë? A do të donit të përfundonte ndryshe? Çfarë do të kishit bërë ju, në një rast të tillë?</i>). <p>Të lexuarit e teksteve letrare</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon poezi, përralla nga folklori, përralla nga autorë të ndryshëm, tregime, fabula, gjëegjëza etj.; - përcakton dy-tre tipare të përrallave, fabulave, tregimeve, poezive; - përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilat janë personazhet e preferuara; - analizon personazhet e teksteve (dallon tiparet kryesore të tyre rreth pamjes së jashtme, sjelljes etj.); - dallon elemente të tekstit, të tilla si: paragrafi, rreshti, strofa, vargu; - tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin; - krahason poezinë me gjëegjëzën, përrallën me tregimin. <p>Të lexuarit e teksteve jo letrare</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon tekste jo letrare, si: ditarë, udhëzime, letra, fjalorë të thjeshtë, shkrime nga revistat etj.; - veçon disa elemente të teksteve, si: titujt, kapitujt dhe ilustrimet, p.sh., <i>në një kalendar dallon vitin, muajt, ditët; në një kartolinë dallon frazat hyrëse, urimin dhe dërguesin e kartolinës etj.</i>; - komenton ilustrimin e një teksti.
<p>Vlerat dhe qëndrimet</p>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - tregon interes dhe dëshirë për të lexuar; - shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit; 	

- ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit.

4.2 Të shkruarit e kuptimshëm

Rezultatet e të nxënit	
Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - shkruan për të komunikuar idetë e veta tek të tjerët nëpërmjet fjalëve, fjalive etj.; - shkruan tekste të thjeshta për qëllime të ndryshme. 	
Njohuritë	Aftësitë
<ul style="list-style-type: none"> - Diktimit. - Shkrimi i një teksti duke u bazuar në një skemë të dhënë. - Përshkrime të thjeshta të një pikturë ose të një fotografie. - Përshkrim i thjeshtë i një personazhi. - Përshkrim i thjeshtë për një njeri të afërm, një shok ose një kafshë shtëpiake. - Rrëfimi i një historie personale (gjysmë faqe). - Shkrimi i tregimeve të thjeshta, nisur nga disa ilustrime. - Shkrimi i një letre të thjeshtë, drejtuar një shoku ose një shoqeje. - Shkrimi i një urimi për një ditëlindje ose me rastin e një feste. - Shkrimi i një plani ditor të thjeshtë. 	<p>Shkrimi i dorës</p> Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - shkruan shkronjat e gjuhës shqipe; - respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve dhe fjalive; - shkruan fjalë me tri - katër rrokje; - kopjon pjesë që kanë dialog, deri në 3-4 fjali; - shkruan fjalë dhe fjali me të diktuar; - u përgjigjet me shkrim pyetjeve të thjeshta. <p>Planifikimi, organizimi, rishikimi dhe redaktimi i të shkruarit</p> Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - pyet për t'u sqaruar rreth tekstit që do të shkruajë; - studion modele të gatshme të punëve me shkrim (<i>p.sh.: modele letrash, përshkrimesh, urimesh</i>); - shkruan për tema të përshtatshme për moshën e tij; - shkruan një tekst të shkurtër (gjysmë faqe) për një temë të caktuar; - bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit. <p>Të shkruarit për qëllime personale</p> Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - shkruan tregime të thjeshta nisur nga figurat e dhëna; - përshkruan me fjalët e tij si e kupton një pikturë, një pamje apo një fotografi;

	<ul style="list-style-type: none"> - shkruan hyrje dhe mbyllje të tjera të një tregimi ose përralle; - përshkruan shokë, miq, të afërm, personazhe, objekte, sende e kafshë të dashura për të; - rrëfen histori e përvoja personale duke u ndihmuar nga pyetjet: <i>Kush? Cili? Çfarë? Si? Kur? Ku?</i> <p>Të shkruarit për qëllime funksionale</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan tekste të shkurtra (një urim, një kartolinë, një letër drejtuar një shoku) duke përdorur një model të thjeshtë; - harton një plan të thjeshtë të regjimit ditor.
Vlerat dhe qëndrimet	
Nxënësi:	
<ul style="list-style-type: none"> - shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; - respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; - vlerëson punët e të tjerëve; - bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. 	

V. ZBËRTHIMI I PROGRAMIT TË LEXIM- SHKRIMIT

A) Për nxënësit që do të ndjekin të dyja modulet, rekomandohet kjo ndarje orësh.

Moduli 1		
Lexim- shkrimi fillestar		
Nr.	Njësitë mësimore	Orët
1.1.	Mësimi i 6 shkronjave të para (lexim dhe shkrim).	6 orë
1.2	Rimarrje e 6 shkronjave të para.	2 orë
1.3	Mësimi i 6 shkronjave të dyta (lexim dhe shkrim).	6 orë
1.4	Rimarrje e 6 shkronjave të dyta.	2 orë
1.5	Mësimi i 6 shkronjave të treta (lexim dhe shkrim).	6 orë
1.6	Rimarrje e 6 shkronjave të treta.	2 orë
1.7	Mësimi i 6 shkronjave të katërta (lexim dhe shkrim).	6 orë
1.8	Rimarrje e 6 shkronjave të katërta.	2 orë
1.9	Mësimi i 6 shkronjave të pesta (lexim dhe shkrim).	6 orë
1.10	Rimarrje e 6 shkronjave të pesta.	2 orë
1.11	Mësimi i 6 shkronjave të gjashta (lexim dhe shkrim).	6 orë
1.12	Rimarrje e 6 shkronjave të gjashta.	2 orë
1.13	Përforcimi i teknikës së lexim- shkrimit. Ushtrime për rrjedhshmërinë në lexim.	7 orë

1.14	Në dispozicion të mësuesit (përforcime, vlerësime etj.).	5 orë
Gjithsej		60 orë

Moduli 2		
Lexim- shkrimi i kuptimshëm		
<i>Shënim: Ndarja e kohës mësimore është orientuese, pasi nxënësit do të punojnë për rrjedhshmërinë, do të punojnë për leximin e kuptueshëm dhe do të shkruajnë çdo orë mësimi.</i>		
Nr.	Njësitë mësimore	Orët
2.1.	Ushtrime për rrjedhshmërinë në lexim.	4 orë
2.2	Studim i teksteve letrare: <ul style="list-style-type: none"> - Përralla - Fabula - Tregime të shkurtra - Poezi - Fragmente tekstesh letrare etj. <i>Shënim: Tekstet duhet të jenë të thjeshta dhe të shkurtra (gjysmë faqeje).</i> Studim i teksteve jo letrare: <ul style="list-style-type: none"> - Kalendarë të thjeshtë - Rregulla praktike - Kartolina - Letra 	19 orë
2.3	Të shkruarit dhe diktimit	13 orë
2.4	Në dispozicion të mësuesit (përforcime, vlerësime etj.).	4 orë
Gjithsej		40 orë

A) Për nxënësit që do të ndjekin vetëm modulin e dytë.

Moduli 2		
Lexim- shkrimi i kuptimshëm		
<i>Shënim: Ndarja e kohës mësimore është orientuese, pasi nxënësit do të punojnë për rrjedhshmërinë, do të punojnë për leximin e kuptueshëm dhe do të shkruajnë çdo orë mësimi.</i>		
Nr.	Njësitë mësimore	Orët
2.1.	Ushtrime për rrjedhshmërinë në lexim.	5 orë
2.2	Studim i teksteve letrare: <ul style="list-style-type: none"> - Përralla - Fabula - Tregime të shkurtra - Poezi - Fragmente tekstesh letrare etj. <i>Shënim: Tekstet duhet të jenë të thjeshta dhe të shkurtra (gjysmë faqeje).</i>	35 orë

	Studim i teksteve jo letrare: - Kalendarë të thjeshtë - Rregulla praktike - Udhëzime - Kartolina - Letra - Ditar - Tekste nga revista për fëmijë	
2.3	Të shkruarit dhe diktimit	16 orë
2.4	Në dispozicion të mësuesit (përf forcime, vlerësime etj.).	4 orë
Gjithsej		60 orë

VI. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Metodat e të nxënimit janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një proces mësimor efektiv. Mësuesit duhet të përditësojnë njohuritë rreth metodave, teknikave dhe strategjive të mësimdhënies, me qëllim që të zhvillojnë te nxënësit njohuritë, aftësitë, vlerat, vlerat dhe qëndrimet e domosdoshme për të nxënimit gjatë gjithë jetës.

Për zbatimin e programit të leximit – shkrimit, mësuesit duhet të aftësojnë nxënësit që të përdorin strategjitë e të lexuarit, të cilat do t’u shërbejnë për të kuptuar dhe për të mos e harruar atë që kanë lexuar. Këto strategji janë:

Parashikimi- Lexuesit e mirë i parashtrajnë vetes pyetje para se të lexojnë duke e shikuar titullin dhe fotografitë: *Për çfarë bën fjalë ky tregim? Pse mendoj kështu? Çfarë mund të mësoj? A di diçka në lidhje me këtë temë?*

Vizualizimi- Lexuesit e mirë krijojnë pamje në mendjen e tyre kur lexojnë. Kjo i ndihmon ta mbajnë mend dhe ta kuptojnë më mirë atë që lexojnë.

Parashtrimi i pyetjeve- Lexuesit e mirë i parashtrajnë vetes pyetje për t’u siguruar se e kanë kuptuar tekstin: *A kishte kjo kuptim për mua? A pati ndonjë pjesë që më duhet ta lexoj sërish?*

Bërja e lidhjeve- Lexuesit e mirë bëjnë lidhje me gjërat tjera që i kanë lexuar, apo atë që tashmë e dinë. Kjo mund të bëhet para, gjatë apo pas leximit: *Çfarë më kujtoi ky tregim? A është ky tregim i ngjashëm me të tjerët që kam lexuar? A është i ndryshëm?*

Nxjerrja e informacionit- Lexuesit e mirë nxjerrin informacione ose lexojnë mes rreshtave. *Çfarë po ndodh në tregim që nuk është thënë? Pse po ndodhin këto gjëra? Çfarë mendon apo ndjen personazhi?*

Përcaktimi i rëndësisë- Lexuesit e mirë arrijnë të gjejnë se cilat pjesë të tregimit janë të rëndësishme dhe cilat nuk janë: *Çfarë dëshiron të thotë autori? A ka tregimi ndonjë mesazh?* Përveç strategjive të të lexuarit, mësuesit duhet të zhvillojnë veprimtari të ndryshme, si dhe të përdorin teknika dhe metoda të të lexuarit ndërveprues. Kështu gjatë zhvillimit të të dy moduleve këshillohet puna në grup ose në çift, diskutimi i strukturuar, diskutimi për njohuritë paraprake, leximi i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikimi me terma paraprake, kubimi, ditari dypjesësh, loja me role, skeda e personazheve, harta e tregimit etj.

6.1 Kriteret e procesit mësimor

- Mësimdhënie me në qendër nxënësin

Nxënësit do të jenë në qendër të procesit të mësimdhënies. Ky proces do të ndërtohet në varësi të nevojave, aftësive dhe interesave të nxënësve. Nxënësit janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Ky fakt dikton nevojën për strategji të ndryshme të të nxënësve, të cilat përshtaten me objektin e të nxënësve dhe me nevojat e nxënësve.

- Të mësuarit bashkëveprues

Mësuesit do të sigurojnë një mjedis të pasur dhe nxitës për komunikim dhe ndërveprim mes nxënësve. Ata do të përdorin metoda, strategji dhe teknika që nxitin të mësuarit bashkëveprues. Gjatë orëve të mësimin, nxënësit do të nxiten të punojnë shpesh së bashku. Detyrat e përbashkëta do t'u sigurojnë nxënësve më shumë kohë për të folur dhe për të ndarë përvojat e tyre me njëri-tjetrin. Njëherazi, edhe shkalla e zotërimit të aftësive të lexim- shkrimit do të rritet.

VII. VLERËSIMI I NXËNËSIT

Vlerësimi i nxënësve është ndër komponentët më të rëndësishëm të procesit mësimor. Mësuesi, në përputhje me parimet themelore të vlerësimit, siguron përdorimin e të gjitha llojeve të vlerësimit, të cilët përcaktohen si të domosdoshëm për të vlerësuar arritjet dhe zhvillimin individual, për të evidentuar anët dhe pikat e forta, si dhe drejtimet të cilat çdo nxënës ka nevojë për ndihmë, mbështetje dhe motivim.

Vlerësimi i nxënësit në lexim- shkrim do të bëhet me përshkrim, me 5 nivele/ shkallë vlerësimi² si më poshtë:

- *Shkalla 1 “Arritje të pakënaqshme”*, kur nxënësi nuk përmbush kërkesat bazë të të lexim-shkrimit. Nxënësi që paraqet arritje të pakënaqshme plotëson pak detyra; ka nevojë të kujtohet shpesh për të bërë detyrat dhe është rrallëherë i motivuar; detyrat i mungojnë, janë të paplotësuara, të pasakta dhe mund t’i dorëzojë me vonesë.
- *Shkalla 2 “Arritje që kanë nevojë për përmirësim”*, kur nxënësi ka arritur vetëm pak nga kërkesat bazë të lexim- shkrimit dhe kërkohet mbështetje dhe punë e vazhdueshme nga ana e tij dhe e mësuesit. Nxënësi që paraqet arritje që kanë nevojë për përmirësim është i motivuar për të plotësuar detyrat, megjithatë disa prej tyre mund të mos i zhvillojë plotësisht; herë pas here duhet kujtuar që të bëjë detyrat; ndonjëherë dëgjon me vëmendje dhe merr pjesë në aktivitete dhe diskutime dhe punon bashkërisht në grupe.
- *Shkalla 3 “Arritje të kënaqshme”*, kur nxënësi ka përmbushur kërkesat bazë të lexim-shkrimit dhe, kur me mbështetjen e mësuesit, arrin të përparojë. Nxënësi që paraqet arritje të kënaqshme zakonisht është i motivuar dhe i përqendruar në detyra; i plotëson detyrat në kohë; zakonisht dëgjon me vëmendje, merr pjesë në diskutime dhe bashkëpunon në grup.
- *Shkalla 4 “Arritje shumë të kënaqshme”*, kur nxënësi ka përmbushur pjesën më të madhe të kërkesave të lexim- shkrimit. Nxënësi që paraqet arritje shumë të kënaqshme është i vetëmotivuar; i plotëson detyrat me kënaqësi; shpesh kërkon dhe vihet përpara sfidave; thuhet gjithmonë dëgjon me vëmendje, merr pjesë në diskutim dhe punon bashkërisht në grupe.
- *Shkalla 5 “Arritje të shkëlqyera”*, kur nxënësi përmbush plotësisht dhe me cilësi kërkesat e programit të lexim- shkrimit. Nxënësi që paraqet arritje të shkëlqyera është i vëmendshëm; është i vetëdrejtuar; kërkon sfida; plotëson detyrat me entuziazëm; ndërmerri iniciativa; merr pjesë me entuziazëm në diskutime; kontribuon në ndërveprimin efektiv të grupeve bashkëvepruese; merr përgjegjësi për të zgjeruar rritjen personale dhe akademike.

Mbajtja e shënimeve për ecurinë dhe përparimin e nxënësve përgjatë gjithë zbatimit të programit, do të bëhet në një evidencë të veçantë, e cila është objekt monitorimi nga stafi drejtues i shkollës dhe nga inspektimi. Nxënësi do të vlerësohet për përgjigjet me gojë dhe me shkrim, për detyrat e shtëpisë, për detyrat e klasës, për testet etj.

²Kodet e shprehura me numra, nga 1 deri në 5 korrespondojnë me shkallët e vlerësimit përshkrues.

Në përfundim të programit të lexim- shkrimit nxënësit do të testohen për arritjet e tyre nga Qendra e Shërbimeve Arsimore. Testi do të masë njohuritë dhe aftësitë e përcaktuara në këtë program.

VIII. MATERIALE DHE BURIME MËSIMORE

Për zhvillimin e programit të lexim- shkrimit mund të përdoren tekstet mësimore të gjuhës shqipe (klasat I- III). Mësuesit do të përzgjedhin vetë tekstet dhe fragmentet e përshtatshme për nxënësit nga këto tekste. Këto tekste dhe fragmente duhet të jenë të thjeshta dhe jo shumë të gjata. Gjithashtu këshillohet të përdoret tabela e rrokjeve, përdorimi i etiketave (fishave) me fjalë të ndryshme për t'u lexuar nga nxënësit, si dhe markerat për përshkrimin e shkronjave e fjalëve në etiketa si nga mësuesi ashtu dhe nga nxënësit.